



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**

Në mbështetje të nenit 52, paragrafi 52.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të nenit 45, paragrafi 45.2 i Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010 dhe të nenit 4, pika 4.3 e Rregullores për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme në Komunën e Prishtinës, kryesuesi i Komitetit për Politikë dhe Financa të Komunës së Prishtinës,

**th ë r r e t**

mbledhjen e **katërt** të Komitetit për Politikë dhe Financa, e cila do të mbahet më **06.07.2016**, dhe do të fillojë në orën **15:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e Këshillit të Drejtorëve (kati II) të Komunës së Prishtinës.

Për mbledhje propozon këtë

**REND TË DITËS:**

1. **Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
2. **Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Propozimplanit rregullues të Hollësishëm "Kalabria" në Prishtinë;**
3. **Rishqyrtimi i Vendimit për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit Rregullues të Hollësishëm të lagjes "Kodra e Trimave 1" në Prishtinë.**
4. **Rishqyrtimi i Vendimit për lënie në dispozicion për shqyrtim publik të Propozimplanit Rregullues të Hollësishëm të lagjes "Mati 2" në Prishtinë.**
5. **Rishqyrtimi i Vendimit për miratimin e Planit Rregullues të Hollësishëm "Sofalia", në Prishtinë 2016-2024.**
6. **Propozimvendimi për fillimin e hartimit të Planit Rregullues të Hollësishëm për "Blloqet B17, B18, B19 dhe B20 - Lagja Mati 1" në Prishtinë 2016-2024;**
7. **Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Ambasadës Çeke;**
8. **Miratimi i planit të veprimit rinor lokal 2016 - 2018;**
9. **Informatë mbi menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve;**
10. **Të ndryshme.**

**KRYESUESI I KOMITETIT**  
**Halim Halimi, jur. i dipl.**

*Vërejtje: Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. kontaktues: 038/230-900, lok. 1100.*